

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOLEGJI PUBLIK NDËRKOMBËTAR I BIZNESIT (IBCM)

Për Aktivitetin e Prokurimit: 208/97950-26-4388-1-3-6

Nr i brendshëm: IBCM97950-26-025-136

Sa i përket tenderit për: Furnizim me pajisje për qendrën e inovacionit dhe biznesit ne IBCM

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

TONI O.P.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kërvasari

(Adresa)

Malishevë

24 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 855 318

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

NAIM BYTYÇI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@toni-ks.com

(Adresa elektronike)

07.09.2026

(Data)



(nënshkrimi)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- | |
|--|
| <ol style="list-style-type: none">1. Njoftim per Kontrat 08.06.20262. Proces verballi i hapjes se Tenderve 15.06.20263. Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 07.07.20264. Kërkesë për rishqyrtim 09.07.20265. Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 09.07.20266. Ankesa ne OSHP: 14.07.2026 |
|--|

7. Vendimi i PSH 11.08.2026
8. Njoftim mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues ri-vleresimi 01.09.2026
9. Kërkesë për rishqyrtim 01.09.2026
10. Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 03.09.2026
11. Ankesa ne OSHP: 07.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Hapja është bërë përmes platformes së E-Prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Jemi njoftuar përmes Vendimit të AK-se dhe Letrës standarde.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092,

Shkeljet në këto nene:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.002/2024 për Prokurimin Publik

Shkeljet në këto nene:

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 97 Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shitesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne operatori ekonomik "TONI O.P.", në cilësinë e palës me interes juridiko-material, parashtrojmë këtë ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.09.2026 dhe Vendimit mbi Kërkesen për Rishqyrtim të datës 03.07.2026, si palë e pakënaqur me ri-vlerësimin e ofertave i paraqesim faktet dhe argumentet tona:

AK – KOLEGJI PUBLIK NDËRKOMBËTAR I BIZNESIT (IBCM), gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave, ka vepruar kundërshtim me:

1. Raportin e Ekspertit Shqyrtues, me të cilin është pajtuar edhe vetë Autoriteti Kontraktues .
2. Ka rekomanduar për dhënien e kontratës OE i cili është palë pa interes, ashtu siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP-së, si dhe në vendime të shumta të OSHP-së.
3. Nuk ka respektuar dhe zbatuar dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për

Prokurimin Publik, si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi, si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural.

Pretendimi ankimor 1: Shkelja e afateve ligjore për zbatimin e vendimit të OSHP-së dhe rekomandimi për kontratë i një Operatorin Ekonomik (palë pa interes) të eliminuar më parë nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për ri-vlerësimin, të datës 01.09.2026, Autoriteti Kontraktues – Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit (IBCM) – ka cenuar rëndë parimet themelore të prokurimit publik, si dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit të prokurimit publik, pasi që, nuk ka respektuar afatet ligjore për zbatimin e vendimit të OSHP-së të datës 11.08.2026.

Konkretisht, ZPP-Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 97.1, pika (p), të Rregullores për Prokurimin Publik duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së brenda afatit të përcaktuar ligjor. Vendimi i OSHP-së është nxjerrë më 11.08.2026, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin përfundimtar të ri-vlerësimit vetëm më 01.09.2026, pra pas kalimit të afatit ligjor.

Përveç shkeljes së afatit ligjor, vendimi i Autoritetit Kontraktues është i kundërligjshëm edhe për nga rezultati i procesit të ri-vlerësimit, pasi që AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE "INFINITT" SH.P.K., ndonëse i njëjti ishte eliminuar më parë nga vetë Autoriteti Kontraktues me Vendimin e datës 07.07.2026.

Sipas vendimit të datës 07.07.2026, AK e kishte konstatuar se OE "INFINITT" SH.P.K. nuk i përmbushte kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe e kishte eliminuar ofertën e tij nga procedura e prokurimit, për arsyet e mëposhtme:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Nuk i përmbushni specifikimet teknike të kërkuara nga AK sepse në Aneksin 1-Specifikimet Teknike të Detyrueshme keni vërtetuar se përmbushni specifikën për build volume 300x300x330mm, kurse në katalog është cekun 220x250x270;

Është kontradiktore dhe e pakuptueshme që, pas një konstatimi të tillë të bërë nga vetë AK, i njëjti OE të rekomandohet më pas për dhënie të kontratës.

Për më tepër, OE "INFINITT" SH.P.K. nuk e ka kundërshtuar arsyen e eliminimit të tij në vendimin e datës 07.07.2026, që do të thotë se është pajtuar me këtë arsye të eliminimit.

Ndërsa, OE "INFINITT" SH.P.K., është pajtuar me vendimin e datës 07.07.2026, pasi që nuk e ka kundërshtuar këtë arsye të eliminimit. Megjithatë, për çudi, AK në vendimin e ri-vlerësimit rekomandon për kontratë një OE i cili më herët është eliminuar nga vetë AK dhe nuk ka pasur statusin e palës me interes në procedurën pranë OSHP-së, ashtu sic përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP-së, ku thuhet: *"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar."*

Si përfundim, AK ka shpërblyer me kontratë OE "INFINITT" SH.P.K., ndonëse ky OE nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, fakt ky që është konstatuar më parë edhe nga vetë AK - KOLEGJI PUBLIK NDËRKOMBËTAR I BIZNESIT (IBCM) me vendimin e datës 07.07.2026. Mospërmbushja e kërkesave të përcaktuara në DT, shihet qartë gjithashtu nga katalogu i ofruar nga vetë OE "INFINITT" SH.P.K., i cili nuk dëshmon përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara.

Por, AK e shfrytëzon Raportin e Ekspertit Shqyrtues, në të cilin ne jemi palë ankuese, për të devijuar procesin e rivlerësimit, ndonëse Eksperti Shqyrtues ka rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim dhe që të kërkohet sqarim nga ne, si OE palë ankuese dhe palë me interes.

Ndërsa AK gjatë procesit të rivlerësimit i kërkon sqarime OE të rekomanduar "INFINITT" SH.P.K., në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe rregulloreve në fuqi, duke i mundësuar OE-së që të ndryshojë në tërësi modelin e ofertuar. Gjatë fazës së ofertimit, OE rekomanduar ka ofertuar modelin "PRUSA CORE ONE". Bashkëngjitur gjeni katalogun e nënshkruar dhe vulosur nga "INFINITT" SH.P.K., ku qartë shihet se ky model nuk i plotëson specifikimet e kërkuara nga AK.

Ndërsa, në Aneksin 1, OE vetëm i ka përshkruar specifikimet e kërkuara, por katalogu i paraqitur nuk përputhet me këto specifikime. Për më tepër, gjatë fazës së rivlerësimit, AK nuk mund të lejojë një ndryshim substancial të ofertës, duke i

mundësuar OE-së që të ndryshojë tërësisht modelin e ofertuar, pasi një veprim i tillë përbën ndryshim të ofertës pas përfundimit të afatit të ofertimit.

Andaj, AK- KOLEGJI PUBLIK NDËRKOMBËTAR I BIZNESIT (IBCM) me publikimin e Formularit B58 – Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.09.2026, nuk ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dispozitat Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092, si dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.002/2024 për Prokurimin Publik, si dhe dispozitat e tjera ligjore, keni nxjerrë vendim me tendencën për prolongimin dhe zvarritjen e mëtejshme të kësaj procedure të prokurimit duke cenuar rëndë nenet 1 dhe 7 të LPP-së.

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet tona të bazuara në fakte dhe argumente, kërkojmë nga Eksperti/ja Shqyrtues/e dhe Anëtarët e PSH të ORGANI SHQYRTUES TE PROKURIMIT, që të merrë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE : “TONI” O.P. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje për qendrën e inovacionit dhe biznesit ne IBCM” me nr. te prokurimit: 208/97950-26-4388-1-3-6 dhe Nr i brendshëm: IBCM97950-26-025-136.

II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit te lartëcekur dhe lënda kthehet ne Rivlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dinamika kohore.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.